



103

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË****BASHKIA VLORË  
DREJTORIA E URBANISTIKËS**Nr. 3856 ProtVlorë, më 2005 2026**PROJEKT VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ 2026

**“PËR NJË SAKTËSIM NË VKB-NË NR. 109 DATË 23.12.2025, “PËR DHËNIEN E DAKORTËSISË PËR KRIJIMIN E SERVITUTIT TË KALIMIT PUBLIK NË PASURINË E PËRCAKTUAR NË PLANIN E RILEVIMIT, ZONA KADASTRALE NR.3467 NË FAVOR TË PASURISË NR.2/2/2, ZONA KADASTRALE NR.3467”**

Në mbështetje të nenit 113 pika 1, shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Neneve 261 - 292 të Ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, “Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Nenit 8, pika 2, të nenit 9, pika 1, nënpika 1.2, shkronja “c”, nenit 54 shkronja “e/1” të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; Nenit 34 të Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar; Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”; Vendimit të Këshillit të Bashkisë Vlorë Nr. 12, datë 28.01.2025, “Për dhënien e pëlqimit për një ndryshim në sipërfaqen e kontratës së qirasë e lidhur midis Bashkisë Vlorë dhe subjektit “Agri” shpk”; bazuar në kërkesën nr.10261, datë 29.09.2025, të shoqërisë “OSSH”, sh.a, protokolluar në Bashkinë Vlorë me nr.15968, datë 02.10.2025; Shkresën nr. 1503/1, datë 02.03.2026, e AZHT, protokolluar në Bashkinë Vlorë me nr.21313/3, datë 05.03.2026 si dhe në shkresën me Nr. 352/1 prot, datë 08.04.2026, protokolluar pranë Bashkisë Vlorë me Nr. 6814 prot, datë 09.04.2026, me lëndë “Plotësim dokumentacioni sipas kërkesës për informacion ardhur nga AZHT Nr. 1503/3 prot, datë 24.03.2026” (bashkëlidhur shkresa me Nr. 1503/3 prot, datë 24.03.2026 dhe Plan Rilevimi Nënstatcioni Akërnë 110-35-20 KË), si dhe shkresës me nr.452/1 prot., datë 14.05.2026 e “OSSH”, sh.a., protokolluar pranë Bashkisë Vlorë me nr 6814/2 prot., datë 15.05.2026, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_. 2026,

**VENDOSI:**

1. Në pikën 1 të Vendimit të Këshillit Bashkiak Vlorë me Nr.109, datë 23.12.2025 të bëhet saktësimi si më poshtë:

- Pasuria e indentifikuar me ngjyrë jeshile sipas planit të rilevimit, Zona Kadastrale Nr. 3467 e cila përcaktohet si pronë shërbyese, të saktësohet se kjo pasuri përbën kanal ekzistues me funksion kullues/ujitës.
  - Krijimi i servitutit të kalimit publik do të realizohet sipas planimetrisë bashkëlidhur pa cënuar funksionin e kanalit nëpërmjet ndërtimit të një tombino (urë kalimi) sipas projektit teknik përkatës, duke garantuar rrjedhën e lirë të ujërave.
  - Subjekti përfitues të kryejë mirëmbajtjen e strukturës së ndërtuar dhe të mbajë përgjegjësi për çdo dëmtim.
2. Të gjitha dispozitat e tjera të Vendimit Nr. 109, datë 23.12.2025, mbeten të pandryshuara.
  3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve dhe Njësia Administrative Novoselë.
  4. Ky vendim hyn në fuqi sipas parashikimeve të nenit 55/6 të të Ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

**KRYETAR**  
**Brunilda Mersini**

**ME URDHER DHE DELEGIM**  
**NËN KRYETAR**  
**Joljana Llanaj**

